



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 6113 Prot.

Tiranë, më 15.9. 2020

**Lënda:** Raporti i monitorimit për 8-mujorin për vitin 2020

**Drejtuar:** **MINISTRISË SË FINANCAVE DHE EKONOMISË**

**DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË BUXHETIT**

Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (KPK), është institucion shtetëror i krijuar në mbështetje të nenit 78 dhe nenit C të Kushtetutës, si dhe të nenit 18, pika 1, dhe nenit 29 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

Në zbatim të Ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, Udhëzimit nr. 22, datë 17.11.2016, “Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit në Njësitë e Qeverisjes Qendrore” si dhe të Udhëzimit plotësues të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, nr.2, datë 20.01.2020, “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2020”, po ju dërgojmë informacionin e mëposhtëm në kuadër të raportit të monitorimit për 8-mujorin e vitit 2020 për institucionin tonë.

Për 8-mujorin e vitit 2020, Komisioni rezulton me një fond buxhetor në total në vlerën 190,350,000 lekë, i ndarë sipas artikujve përkatës. Realizimi si 8-mujor për vitin 2020, në total është në vlerën 122,412,627 lekë.

Përsa i përket treguesve të performancës, theksojmë se numri i dosjeve të shortuara gjithsej prej fillimit të aktivitetit të Komisionit është në **635 subjekte rivlerësimi**.

Gjatë 8-mujorit të vitit 2020 janë marrë **65 vendime**.

Numri i dosjeve të marra në shqyrtim për periudhën **Janar – Gusht 2020** është afërsisht **250 dosje**.

Artikulli **600**, zëri **Paga**, plani buxhetor vjetor është në vlerën 142,800,000 lekë. Realizimi për 8-mujorin për vitin 2020 arriti në vlerën 95,997,363 lekë.

Numri në total i punonjësve të përhershëm të miratuar me Vendimin Nr. 100/2018 të Kuvendit për Komisionin e Pavarur të Kualifikimit, për 8-mujorin për vitin 2020 është 64 punonjës.

Gjithashtu, me Vendimin të Këshillit të Ministrave Nr. 102, datë 27.02.2019, “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 16, datë 16.01.2019, të Këshillit të Ministrave, *Për punonjësit me kontratë të përkohshme për vitin 2020 në njësitë e qeverisjes qendrore*”, janë miratuar edhe 5 punonjës me kontratë.

Viti 2020 filloi me një numër punonjësish të përhershëm prej 62 persona, ndërsa në fund të 8-mujorit për vitin 2020, ky numër arriti në 60 punonjës të përhershëm dhe 4 punonjës me kontratë, në total 64 punonjës.

Artikulli **601**, zëri **Kontribute për Sigurimet Shoqërorë**, plani buxhetor vjetor është në vlerën 13,400,000 lekë. Realizimi si 8-mujor arriti në shumën 8,907,666 lekë.

Artikulli **602**, zëri **Mallra dhe Shërbime**, plani buxhetor vjetor është në vlerën 30,000,000 lekë. Realizimi si 8-mujor arrit në vlerën 17,457,598 lekë.

Artikulli **606**, zëri **Transferta në buxhetet e familjarëve dhe individëve**, plani buxhetor vjetor, miratuar nga fondi i veçantë për vitin 2020, është në vlerën 150,000 lekë. Realizimi si 8-mujor arriti në shumën 50,000 lekë.

Artikulli **231**, zëri **Shpenzime Kapitale të Trupëzuara**, plani buxhetor vjetor është në vlerën 4,000,000 lekë. Realizimi si 8-mujor ishte 0 lekë.

Bashkëngjitur, tabela për realizimin e shpenzimeve për 8-mujorin për vitin 2020.

**Duke Ju falënderuar për bashkëpunimin!**

**KRYETARE**

**PAMELA QIRKO**



Tabela e realizimit të shpenzimeve për 8-mujorin2020

KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT				Kodi i Institucionit 1063002		në leke	
Gr	Tit	Emërtimi i Institucionit Buxhetor / Programit	Kap	Emer Kapitulli			
63	3330	Veprimtaria e rivlerësimit kalimtar të magjistratit	1	Çelje nga buxheti			
					<b>600</b>	<b>Pagat</b>	
					<b>Plan</b>	<b>Fakt</b>	
					142 800 000	95 997 363	
					<b>601</b>	<b>Kontributet e Sigurimeve Shoqërore</b>	
					<b>Plan</b>	<b>Fakt</b>	
					13 400 000	8 907 666	
					<b>602</b>	<b>Mallra dhe Shërbime</b>	
					<b>Plan</b>	<b>Fakt</b>	
					30 000 000	17 457 598	
					<b>606</b>	<b>Transferata për buxhetet e familjarëve dhe Individët</b>	
					<b>Plan</b>	<b>Fakt</b>	
					150 000	50 000	
					<b>231</b>	<b>Shpenzime Kapitale të Trupëzuara</b>	
					<b>Plan</b>	<b>Fakt</b>	
					4 000 000	0	
					<b>TOTAL</b>		
					<b>Plan</b>	<b>Fakt</b>	
					190 350 000	122 412 627	